

VENDIM
Nr.127, datë 14.11.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “d”, dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë, të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën për rishqyrtim të aplikimit të paraqitur nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe kostatoi se:

1. Me vendimin nr.121, datë 9.10.2008, Bordi i Komisionerëve vendosi mosfillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për shkak të mosparaqitjes së aplikimit në përputhje me dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë, të pjesshëm dhe rinovimit të licencave.

2. Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë, të pjesshëm dhe rinovimit të licencave në nenin 10 parashikon mundësinë e aplikuesit për të paraqitur një aplikim të ri brenda tre muajve nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurave të licencimit.

3. Aplikimi i ri i shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordin i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta